

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 7026
E premte, 20 tetor 2023
Çmimi 0.50 €

Lideri i PDK-së me bashkëpartiakë dhe me djalin e Thaçit vizitojnë Gucatin | FAQE 6



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE" DEPUTETI I PDK-SË, HISEN BERISHA | FAQE 4-5

VUÇIQI SËRISH KA PLANE PËR TA RREZIKUAR INTEGRITETIN DHE SOVRANITETIN E KOSOVËS NË VERI



Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hisen Berisha, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ka folur për Samitin e Procesit të Berlinit të mbajtur në Tiranë, për deklaratën e presidentit francez Emmanuel

Macron rreth pezullimit të vizave për Kosovën nga Franca, për vizitën e Vuçiqit në Kinë dhe ndikimin e saj në rajon dhe për situatën e sigurisë pas 24 shtatorit në veri të Kosovës. Berisha ka thënë se deklarata e Macronit

është shqetësuese për zotimet që ka marrë kryeministri Kurti në procesin e dialogut. Ndërkaq sa i përket situatës në veri, deputeti i PDK-së thotë se sërish ka rrezik që Serbia të përsërisë skenarë të tjerë në veri

AKTUALE



PSE SHTETET ARABE PO REFUZOJNË TË PRANOJNË REFUGJATË PALESTINEZË NGA GAZA? | F. 2

HARADINAJ TAKON RAMËN NË TIRANË, I KËRKON NDIHMË PËR KOSOVËN | F. 3

NUK KA MË LISTË TË PRITJES PËR TERAPINË ME RREZATIM NË KLINIKËN E ONKOLOGJISË | F. 6

EKONOMI



BANKA BOTËRORE: RRIJTJA EKONOMIKE NË KOSOVË PRITET TË PËRSHPEJTOHET NË VITIN 2024 | F. 8

AKP-ja SHITI 37 ASETE NË VLERË MBI 1.5 MILION EURO | F. 8

SPORT



ASANI: MË KËRKOJNË NGA GJYSMA E EVROPËS, DËSHIROJ TË TRANSFEROHET NË SERINË A | F. 10

PARLAMENTI EVROPIAN MIRATON REZOLUTËN PËR KOSOVËN, DËNON SULMIN TERRORIST NË VERI | FAQE 3



S'KA KUORUM PËR VOTIMIN E REZOLUTËS PËR POLICINË, LV-ja SËRISH NUK MORI PJESË NË SEANCË | FAQE 5



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
+389 44 487 200
+377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Pse shtetet arabe po refuzojnë të pranojnë refugjatë palestinezë nga Gaza?

GAZA, 19 TETOR - Përderisa palestinezët e dëshpëruar në Gazën e rrethuar po tentojnë të gjejnë strehim pas bombardimeve të pareshtura të Izraelit në hakmarrje të sulmit brutal të Hamasit më 7 tetor, disa pyesin se pse Egjipti dhe Jordania fqinje nuk po i pranojnë palestinezët.

Të dy shtetet, që gjenden në anë të kundërta të Izraelit dhe ndajnë kufirin me Gazën dhe me Bregun e pushtuar perëndimor respektivisht, kanë refuzuar pranimin e refugjatëve. Jordania veçse ka një popullatë të madhe palestineze.

Presidenti i Egjiptit, Abdel Fattah el-Sissi, bëri komentet më të ashpra më 18 tetor, duke thënë se lufta aktuale nuk synon vetëm luftimin e Hamasit që udhëheq Rripin e Gazës "por, po ashtu, është një përpjekje për t'i shtyrë banorët civilë që të migrojnë në Egjipt". Ai paralajmëroi se një gjë e tillë mund ta prishë paqen në rajon.

Mbreti i Jordanisë, Abdullah II, dha mesazh të ngjashëm një ditë më parë, duke thënë "asnjë refugjat në Jordani, asnjë refugjat në Egjipt".

Refuzimi i tyre i ka rrënjët në frikën se Izraeli dëshiron të kryejë një dëbim të përhershëm të palestinezëve në shtetet e tyre dhe t'i zhbëjë kërkesat palestineze për shtetësi.

El-Sissi, po ashtu, tha se një eksod masiv do të rrezikonte që militantët të shkonin në gadishullin Sinai të Egjiptit dhe ta përdornin këtë territor për të kryer sulme ndaj Izraelit, duke vënë në rrezik traktatin e paqes që dy shtetet kanë nënshkruar 40 vjet më parë.

Në këtë tekst mund të mësoni arsyet se pse Egjipti dhe Jordania po refuzojnë t'i strehojnë refugjatët nga Rripi i Gazës.

Historia e zhvendosjes

Zhvendosja ka qenë temë kryesore e historisë palestineze. Në luftën e vitit 1948 për krijimin e Izraelit vlerësohet se 700 000 palestinezë u dëbuan ose u zhvendosën nga territori që tani është Izrael. Palestinezët i referohen kësaj ngjarjeje si Nakba, që në gjuhën arabe do të thotë "katastrofë".

Në luftën e Lindjes së Mesme më 1967, kur Izraeli pushtoi Bregun Perëndimor dhe Rripin e Gazës, edhe 300 000 palestinezë të tjerë u zhvendosën, shumica në Jordani.

Refugjatët dhe pasardhësit e tyre tani janë afër 6 milionë dhe shumica jetojnë në kampe dhe komunitete në Bregun



Perëndimor, Gazë, Liban, Siri dhe Jordani. Diaspora është përhapur edhe më shumë, pasi shumë refugjatë janë zhvendosur në shtetet e Gjirit Arabik apo në Perëndim.

Pasi luftimet u ndërpre në luftën e vitit 1948, Izraeli refuzoi ta lejonte kthimin e refugjatëve në shtëpitë e tyre. Që atëherë Izraeli ka refuzuar kërkesat e palestinezëve për kthimin e refugjatëve si pjesë e një marrëveshjeje të paqes, duke argumentuar se diçka e tillë do ta kërcënonte shumicën hebreje të shtetit.

Egjipti ka frikë se historia do të përsëritet dhe një numër i madh i refugjatëve palestinezë nga Gaza do të qëndrojnë në këtë shtet në mënyrë të përhershme.

S'ka garanci për rikthim

Kjo është pjesë e kësaj çështjeje pasi nuk ka një skenar të qartë se si kjo luftë do të përfundojë. Izraeli ka thënë se synon ta shkatërrojë Hamasin për shkak të sulmeve të grupit në qytetet jugore izraelite. Por, nuk ka dhënë asnjë indikacion se çfarë mund të ndodhë më pas dhe kush do ta qeverisë Gazën. Ky fakt ka rritur shqetësimet se do të ketë një ripushtim të territorit për një periudhë kohore, që do të nxiste konflikt të mëtejshëm.

Ushtria izraelite ka thënë se palestinezët që respektojnë urdhrin e saj për t'u zhvendosur nga veriu i Gazës për në pjesën jugore të këtij territori do të lejohen që të kthehen në shtëpitë e tyre pasi lufta të mbarojë.

Por, Egjipti nuk është qetësuar nga kjo deklaratë.

El-Sissi deklaroi se luftimet mund të zgjasin me vite nëse Izraeli argumenton se nuk i ka shtypur mjaftueshëm militantët. Ai ka propozuar që Izraeli t'i strehojë

palestinezët në Shkretëtirën e tij Negev, që gjendet në kufi me Rripin e Gazës, derisa të përfundojnë operacionet ushtarake izraelite. "Mungesa e qartësisë nga Izraeli sa iu përket synimeve të tij në Gazë dhe evakuimi i popullatës së këtij territori është problematike", tha Riccardo Fabiani, drejtor për projektin e Afrikës Veriore në Grupin Ndërkombëtar të Krizave. "Ky konfuzion nxiti frikë në rajon". Egjipti ka kërkuar që Izraeli të lejojë dërgimin e ndihmës humanitare në Gazë dhe të mërkurën Izraeli u pajtua, por nuk tha se kur mund të nisë dërgimi i ndihmave. Sipas Kombeve të Bashkuara, Egjipti - që po përballet me krizë ekonomike - veçse ka pranuar afër 9 milionë refugjatë dhe migrantë, përfshirë edhe afër 300 000 sudanezë që arritën këtë vit në shtet pasi u larguan nga lufta në shtetin e tyre.

Por, shtetet arabe dhe shumë palestinezë, po ashtu, dyshojnë se Izraeli mund ta shfrytëzojë këtë mundësi për të bërë ndryshime të

përhershme të demografisë, që do t'i shkatërronin kërkesat palestineze për shtetësi në Gazë, Bregun Perëndimor dhe në Jerusalemin Lindor që, po ashtu, u pushtua nga Izraeli më 1967.

El-Sissi përsëriti paralajmërimet të mërkurën se një eksod nga Gaza synonte "eliminimin e kauzës palestineze... që është kauza më e rëndësishme e rajonit tonë". Ai argumentoi se nëse një shtet palestinez i çmilitarizuar do të krijohej kohë më parë përmes negociatave, tani nuk do të kishte luftë. "I gjithë precedenti historik tregon faktin se kur palestinezët detyrohen të largohen nga territori palestinez, ata nuk lejohen të kthehen", tha H. A. Hellyer, hulumtues në Institutin për Paqe Ndërkombëtare Carnegie Endowment. "Egjipti nuk dëshiron të jetë bashkëfajtor në spastrimin etnik në Gazë".

Frika e shteteve arabe është rritur gjatë kohës së qeverisjes së kryeministrit izraelit Benjamin Netanyahu dhe partnerëve të tij të koalicionit nga krahu i djathtë, të cilët flasin në terma pozitivë për

largimin e palestinezëve. Që nga sulmet e Hamasit retorika është bërë më pak e frenueshme, me disa politikanë të krahut të djathtë dhe analistë që i kanë bërë thirrje ushtrisë ta shkatërrojë Gazën dhe t'i dëbojnë banorët e saj. Një ligjvënës ka thënë se Izraeli duhet të kryejë "një Nakba të re" në Gazë.

Shqetësimet për Hamasin

Në të njëjtën kohë, Egjipti ka thënë se një eksod masiv nga Gaza do të sillte në tokën e tij militantët e Hamasit apo të grupeve të tjera militante palestineze. Kjo do të mund ta destabilizonte Sinain, ku ushtria e Egjiptit për vite të tëra ka luftuar kundër militantëve islamikë dhe e ka akuzuar Hamasin se i mbështet ata.

Egjipti ka mbështetur Izraelin në bllokimin e Gazës që kur Hamasi mori kontrollin e territorit më 2007, duke i kontrolluar të gjitha dërgesat e mallrave dhe hyrje/daljet e njerëzve në këtë territor. Po ashtu, ka shkatërruar rrjetet e tuneleve nën kufi, që Hamas dhe palestinezët e tjerë i përdornin për të kontrabanduar mallra në Gazë.

Me kryengritjen në Sinai gjerësisht të shtypur, "Kajro nuk dëshiron të ketë një problem të ri të sigurisë në këtë rajon problematik", tha Fabiani.

El-Sissi paralajmëroi edhe për një skenar edhe më destabilizues: prishjen e marrëveshjes së paqes Egjipt - Izrael të arritur më 1979. Ai tha se me praninë e militantëve palestinezë, Sinai "do të bëhej bazë për nisjen e sulmeve ndaj Izraelit. Izraeli më pas do të kishte të drejtë ta mbrojtë veten... dhe do ta sulmonte territorin e Egjiptit". "Paqja që ne kemi arritur do të zhdukej nga duart tona", tha ai, duke shtuar se e gjithë kjo do të bëhej "vetëm për hir të idesë për eliminimin e kauzës palestineze". (AP)



Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ

• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQRIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)

• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut

• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Parlamenti Evropian miraton rezolutën për Kosovën, dënon sulmin terrorist në veri

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 19 TETOR - Parlamenti Evropian (PE) ka dënuar ashpër sulmin ndaj policisë në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator, duke e quajtur sulm terrorist dhe ka kërkuar përgjegjësi nga Serbia nëse dëshmohej lidhja e drejtpërdrejtë e Beogradit me këtë ngjarje. Këto janë përfshirë në rezolutën për zhvillimet në dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe zhvillimeve në veri të Kosovës.

Teksti i kësaj rezolute u hodh në votim në seancën plenare të 19 tetorit, kurse është përpiluar duke marrë parasysh disa propozime të grupeve politike në PE. Në tekstin e rezolutës përmenden rrethanat të cilat kanë ndikuar në rritjen e tensioneve në veriun e Kosovës, nga largimi i serbëve nga institucionet nëntorin e kaluar, bojkotimi i zgjedhjeve lokale të prillit në veri e deri te vendosja e barrikadave dhe sulmeve ndaj ushtarëve të KFOR-it dhe gazetarëve në fund të majit dhe sulmit të fundit në Banjskë.

Në tekstin e rezolutës sulmi ndaj Policisë së Kosovës në Banjskë cilësohet "sulm terrorist", përdërisa Serbia kritikohet për disa veprime sikurse mosdistancimi i qartë nga sulmi, madhërimi i pjesëtarëve të grupit të armatosur të serbëve që kryen sulmin dhe shpalljen e Ditës së Zisë në Serbi për tre sulmuesit e vrarë. "Dënojmë në mënyrën më të fuqishme të mundshme sulmin qyqar terrorist ndaj pjesëtarëve të Policisë së Kosovës nga ana e paramilitarëve mirë të organizuar serbë në Banjskë në veri të Kosovës", thuhet në tekstin e rezolutës, në të cilën u bëhet ftesë të gjitha shteteve anëtare të Bashkimit Evropian që deri më tani nuk e kanë dënuar këtë sulm, ta bëjnë një gjë të tillë.

Përmes rezolutës së PE-së u bëhet thirrje Kosovës dhe Serbisë



të veprojnë për uljen e tensioneve, të përmbahen nga retorika apo veprimet që mund t'i rritin tensionet dhe të veprojnë për zbardhjen e të gjitha fakteve lidhur me sulmin në Banjskë. "Bëjmë ftesë që BE-ja t'i mbështesë hetimet nga ana e autoriteteve të Kosovës, përfshirë edhe mbështetjen e [misionit të BE-së në Kosovë për Sundim të Ligjit] EULEX-it, duke nënvizuar rëndësinë që kryesit e këtyre sulmeve të mbahen përgjegjës dhe të përballen me drejtësinë pa vonesë. Ftohen autoritetet e Kosovës që t'i paraqesin të gjitha dëshmitë lidhur me incidentin, Serbisë i kërkohej të bashkëpunojë plotësisht me hetimet dhe t'i sjellë para drejtësisë personat përgjegjës që ndodhen në Serbi, në përputhje me ligjin, përfshirë edhe ekstradimin në Kosovë", thuhet në tekstin e rezolutës të votuar nga deputetët evropianë.

Teksti i rezolutës, po ashtu, u bënë ftesë Komisionit Evropian dhe Këshillit të ndërmarrin masa ndaj Qeverisë së Serbisë nëse

hetimet dëshmojnë për lidhje të drejtpërdrejtë të shtetit të Serbisë me sulmin në Banjskë, ose nëse autoritetet e Serbisë nuk do të tregojnë vullnet për bashkëpunim të plotë në procesin e hetimeve. "Ftohet Këshilli t'i miratojë masat e shënjestruara restriktive, përfshirë, por jo edhe të kufizuara, ngrirjen e pasurisë dhe ndalimin e udhëtimeve për aktorët destabilizues në veri të Kosovës dhe liderët e rrjeteve kryesore të krimit të organizuar. Në këtë kontekst, ftojme Këshillin ta ndjekë shembullin e Shteteve të Bashkuara për vendosjen e masave të shënjestruara kundër Millan Radoiçiqit", thuhet në rezolutë.

Millan Radoiçiq, ish-nënkryetar i Listës Serbe, partisë kryesore të serbëve në Kosovë që gëzon mbështetjen e Beogradit, ka marrë përgjegjësinë për organizimin dhe udhëheqjen e sulmit në Banjskë. Ai veçse gjendet nën sanksione të ShBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar nën dyshime për krim të

organizuar.

PE-ja, përmes kësaj rezolute, po ashtu, dënon edhe rritjen e pranisë së ushtrisë serbe në afërsi të kufirit të Kosovës dhe kërkon nga Serbia të përmbahet nga mbështetja e çfarëdo grupi terrorist në veri të Kosovës në të ardhmen. Po ashtu, kritikohet edhe ajo që cilësohet si gjuhë e ashpër nxitëse që përdoret në Serbi për Kosovën dhe shqiptarët që, sipas eurodeputetëve, nxit tensionet. "Bëhet ftesë për autoritetet në Serbi dhe mediet që të përmbahen nga gjuha e urrejtjes ndaj Kosovës dhe nga përhapja e gënjeshtrave për 'spastrim etnik' apo 'pogrom' në Kosovë, për çka nuk ka dëshmi", thuhet në rezolutë.

Përmes kësaj rezolute, po ashtu, bëhet ftesë për një rol më pro-aktiv të BE-së në dialogun për normalizimin e raporteve, në mënyrë që Kosova dhe Serbia t'i zbatojnë të gjitha pikat e marrëveshjes drejt normalizimit - të arritur më herët gjatë vitit - përdërisa shprehet keqardhje

për rinisjen e fushatës nga Serbia për tërheqjen e njohjeve të Kosovës dhe pengesave për anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Nga Kosova kërkohej që të ketë dialog me serbët në Kosovë dhe të organizojë sa më shpejt zgjedhje të reja lokale në veriun e banuar me shumicë serbe.

Në disa pika të kësaj rezolute shprehet keqardhje për sjelljen e autoriteteve të Serbisë, të udhëhequra nga presidenti Aleksandar Vuçiq që, sipas eurodeputetëve, destabilizojnë tërë rajonin.

Përmes kësaj rezolute, po ashtu, kërkohej të largohen masat ndëshkuese që BE-ja vendosi ndaj Kosovës për shkak të tensioneve në veri që nisën në fund të majit. "Shprehim keqardhje për masat negative të cilat Këshilli ka ndërmarrë ndaj Kosovës dhe kërkojmë që ato të hiqen sa më parë që të jetë e mundur. Kërkohej nga Këshilli dhe Komisioni Evropian që të rifillojnë kontaktet e nivelit të lartë me presidentin dhe Qeverinë e Kosovës", thuhet në tekstin e rezolutës së miratuar.

Eurodeputetët, po ashtu, dënojnë përpjekjet e Rusisë për ndikim në rajonin e Ballkanit Perëndimor, veçmas në raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë dhe kërkohej që të hetohet roli i mundshëm i Rusisë në ngjarjet në Banjskë të Zveçanit më 24 shtator.

Autoritetet e Kosovës kanë deklaruar më herët se po hetohet roli i mundshëm i Rusisë në këtë sulm. Po ashtu, eurodeputetët kërkojnë që të mos vihet në dyshim liberalizimi i vizave për Kosovën dhe kjo çështje të mos lidhet me dialogun Kosovë - Serbi. "Rikujtojmë se marrëveshja për liberalizimin e vizave për Kosovën nuk është dhe nuk duhet të lidhet me dialogun dhe duhet të hyjë në fuqi jo më larg se 1 janari i vitit 2024", thuhet në tekst.

Haradinaj takon Ramën në Tiranë, i kërkon ndihmë për Kosovën

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryetari i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Ramush Haradinaj, ka takuar të enjten në Tiranë kryeministrin e Shqipërisë, Edi Rama. Ai ka thënë se me Ramën pati një takim vëllazëror. "Diskutuam për zhvillimet që po kalon Kosova, Shqipëria dhe rajoni dhe për proceset që na presin, veçanërisht për sfidat e Kosovës në çështjet që kanë të bëjnë me dialogun, sigurinë

dhe perspektivën e integriteteve euro-atlantike. I kërkoja kryeministrit shqiptar që në të gjitha nivelet e bisedave me faktorin ndërkombëtar e kombëtar të ndihmojë në tejkalimin e sfidave që i ka Kosova dhe të përshpejtojë integrimin e saj. E falënderova përzemësisht për kujdesin e tij dhe të Shqipërisë në këtë periudhë jo të lehtë që po kalon Kosova", ka shkruar Haradinaj në "Facebook".



S'ka kuorum për votimin e rezolutës për policinë, LV-ja sërish nuk mori pjesë në seancë

PRISHTINË, 19 TETOR - Kuvendi i Kosovës dështoi të enjten të hidhte në votim një projektrezolutë që kërkon mbështetje urgjente financiare për Policinë e Kosovës për shkak të mungesës së kuorumit.

Votimi për këtë projektrezolutë u shty për ndonjë seancë tjetër.

Në seancën e jashtëzakonshme të 19 tetorit nuk morën pjesë deputetët e partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje.

Seanca e jashtëzakonshme u thirr nga partitë opozitare. Edhe një tjetër seancë për këtë çështje ishte thirrur më 12 tetor, por edhe ajo ka dështuar të mbahej në mungesë të kuorumit, pasi deputetët e LV-së e kanë bojkotuar.

Rashit Qalaj, deputet nga subjekti opozitar Partia Demokratike e Kosovës, tha se Policia e Kosovës është duke punuar në kushte të rënda dhe kjo, sipas tij, nuk duhet lejuar. "Nga hyrja në fuqi, më 5 shkurt 2023, e Ligjit për Paga në sektorin publik, zyrtarëve policorë u është ndaluar shtesa e rrezikshmërisë, shtesë të cilën policët e Kosovës e kanë marrë gjithmonë në të kaluarën. Ky është një vendim i padrejtë, pasi ndikon drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre dhe të familjeve, por edhe në vullnetin dhe motivin përballë punës së përditshme sfiduese.

Shuma totale vjetore e shtesave që kanë marrë policët e Kosovës ka qenë 16 milionë euro, ose 1.3 milion euro në muaj", tha ai.

Pagat e pjesëtarëve të Policisë së Kosovës nisin nga 210 euro në muaj për kadetët policorë e deri mbi 1 500 euro në muaj për drejtorin e përgjithshëm.

Në bazë të ligjit, pagat për zyrtarë e policisë janë rritur nga 20 deri në 60 euro. Këtë rritje policia e ka quajtur minimale.

Anton Çuni nga subjekti opozitar Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) e vlerësoi të papranueshme mungesën e partisë në pushtet në seancën ku diskutohet për të drejtat elementare të policëve. "Disa policë për vite me radhë punojnë pranë aparaturave që rrezatojnë dhe seriozisht dëmtojnë shëndetin. Në vendet e Perëndimit nuk lejohet më shumë se gjashtë muaj. Me vite i bartin të njëjtat uniforma e vet kujdesen për mirëmbajtjen e tyre, punojnë jashtë orarit me kompensim simbolik dhe të fundit shkojnë në shtëpi. Udhëtojnë me trafik urban, ushqehen lirë dhe aspak shëndetshëm. Dhe krejt në fund ata nuk paguhen për punën që po e bëjnë", tha Çuni.

"Pagesa për rrezikshmërinë në punë është obligim i shtetit dhe kjo duhet të ndodhë", tha deputeti



i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, Bekë Berisha. "Mund të bëjmë një fond të posaçëm për policët që bien në detyrë, në mënyrë që të kujdesemi për familjet e tyre. Pastaj është kategoria e invalidëve të punës në polici, të plagosur, ka njerëz edhe me karrocë invalidore. Duhet të ketë një fond të veçantë edhe për ta", tha ai.

Rreshteri Afrim Bunjaku është zyrtari i fundit që është vrarë gjatë

kryerjes së detyrës. Ai është vrarë më 24 shtator në Banjskë të Zveçanit pasi policia është sulmuar nga një grup i armatosur serbësh. Gjatë përlëshjeve mes grupit të armatosur dhe policisë janë vrarë edhe tre sulmues.

Policia e Kosovës ka rreth 9 000 pjesëtarë.

Përmes kësaj rezolute PDK-ja kërkon që 15 ditë nga miratimi i saj të ndahen mjetet për shtesat e rrezikshmërisë për Policinë e

Kosovës. Po ashtu, brenda 60 ditëve të miratohet Projektligji për Pensionim të Parakohshëm të Zyrtarëve Policorë, kurse nga 1 janari 2024 të mbulohet pagesa e sigurimit shëndetësor për zyrtarët policorë.

Zyrtarë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, javën e kaluar kanë thënë se tendenca e PDK-së nuk ka të bëjë me gjendjen e policisë, por synim i tyre është "pushteti dhe jo interesi i shtetit".

saj pro Ruisë e Kinës si dhe mbështetja e terrorizmit ndërkombëtar, jo vetëm në Kosovë. Mbi 30 % e armatimit nga depot e armatimit serb janë shitur për organizatat Hamas e Hazbullah, për të cilat edhe prodhohet enkas nga industria e armatimit në Kragujevc. Po t'u referohemi luftërave që shkaktoi për 30 vjet në Ballkan, Serbia duhet lënë si "gropë septike" derisa të qelben mbeturinat e politikave gjenocidale antishqiptare, antiboshnjake dhe antikroate. Historia na mëson se Mbretëria Serbe keqpërdori fuqinë e Perëndimit dhe e krijoi dhe zgjeroi territorin në dëm të tokave dhe popullit shqiptar, keqpërdori fuqinë e vendeve antifashiste dhe mbrojti territoret e okupuara nga Lufta e Parë Botërore, pastaj përmes Marshallit Tito i shfrytëzoi të gjitha fondet e mundshme të Perëndimit e të Lindjes. Madje përmes "bllokut të të painkuadruarve" voli fonde edhe nga vendet islamike. Me një fjalë, kjo politikë po pretendon të vazhdohet me nismat rajonale, në Tiranë me Bernabiçin dhe në Kinë me Vuçiqin. Mendoj se kombi shqiptar duhet t'i fillojë përgatitjet serioze për t'u mbrojtur nga një riokupim (ndoshta jo klasik e ushtarak), por gjithsesi ata po planifikojnë në detaje kthimin e Serbisë në tokat e çliruara të



Kosovës. Në këtë konotacion nuk lexoj tjetër mesazh, nga vizita e Vuçiqit dhe promovimi i raporteve tradicionale me Kinën e Rusinë.

"Epoka e re": Si e vlerësoni situatën e sigurisë pas 24 shtatorit dhe mundësinë që Serbia të pretendojë edhe ndonjë sulm mbi Kosovën?

Berisha: Krimineli gjithmonë kthehet në vendin e krimit. Po ashtu, Serbia nuk ka pretendime siç po deklarohen shumë vlerësues të situatës, vetëm veriun e Kosovës, por riokupimin e saj ashtu siç e pretendon edhe në Kushtetutën e vet. Prandaj si

ushtarak e vlerësoj se drejtuesit e sigurisë dhe mbrojtjes në Serbi dhe komandanti i tyre suprem, presidenti Vuçiq, kanë edhe plane alternative për ta rrezikuar integritetin dhe sovranitetin e Kosovës në emër të realizimit të planeve politike ndaj Kosovës dhe territorit të saj e pavarësisë politike. Nga prizmi i vlerësimit ushtarak dhe njohjes së doktrinave të operimit të forcave serbe, është e pritshme që kriminelë ushtarakë serbë mund t'i sulmojnë (thyejnë apo hapin depot) në bazat serbe afër kufirit të Kosovës, pra të kamuflohen

sikur po "plaçkiten" nga kryengritës të "rebeluar" për të organizuar një kryengritje të ashtuquajtur popullore dhe një numër i madh i ushtrisë serbe, të cilët hipotetikiqisht gjoja që do të dezertojnë nga ushtria dhe për t'i marrë armët nga kazeremat (bazat) e ushtrisë serbe do t'i vërsulen veriut të Kosovës. Pastaj në brendi të territorit, shumë manastire që përfitojnë nga statusi i pacenueshmërisë siç pretendojnë me planin franko-gjerman, pikën 7 të tij, janë baza armatimi, mobilizimi dhe të koordinimit e mbështetjes logjistike. Kjo duhet të jetë mirë e planifikuar nga Vuçiqi, që të thirret në kryengritje popullore serbe e jo në agresion të Serbisë dhe ushtrisë serbe ndaj Kosovës, nga e cila do të pretendojë të dalë e amnistuar siç bëri me rastin e Banjskës apo infiltrimit të trupave të armatosura ushtarake serbe, të cilësuar nga të gjithë si "grup terrorist dhe aksion terrorist" që e rehabiliton Serbinë nga akuzat për agresion. Si ushtarak po dyshoj në këtë skenar, edhe si njohës i luftës dhe skenarëve të luftës, po paralajmëroj këtë skenar të Vuçiqit. Siç theksova më sipër, Serbia 30 % të armëve i ka shitur Hamasit. Dhe sipas informatave publike mediale, shitja është kryer përmes Rumanisë. Ky furnizim përfshin armatime në

kallashnikovë, municione dhe armë të tjera që preferojnë grupet terroriste. Përgjegjës të përfshirë drejtpërdrejt për shitjen janë Aleksandër Vulin dhe shefi i shtabit të ushtrisë serbe. Prandaj do të duhej që të bëhet kërkesë urgjente ndërkombëtare deri në KS/OKB dhe NATO, t'i mbyllet fabrika e armatimit në Kragujevc, të hetohen depot e armëve të Serbisë, për të konstatuar këtë dhënë inteligjente. Kurse ajo që pres në aspektin politik e diplomatik, është se Izraeli do të duhej ta heqë ambasadorin e vet nga Serbia, e cila shet armë për ta vrarë popullin izraelit.

"Epoka e re": Në kontekst të temave të sigurisë është bërë dëgjimi publik lidhur me Ligjin për Agjencinë e Inteligjencës Ushtarake. Ju keni punuar gjatë në këtë proces. Cili ishte qëndrimi juaj?

Berisha: Nevoja për Agjencinë e Inteligjencës Ushtarake, në kohën kur sfidat e sigurisë po bëhen gjithëherë e më të mëdha, po bëhet e domosdoshme. Sot lufta hibride është një ndër sfidat kryesore. Prandaj, Agjencia e Inteligjencës Ushtarake duhet të jetë pararojë e parandalimit të tyre. Por, jo vetëm këtë, por çdo lloj rreziku, edhe çdo lloj komponenti që e rrezikon sigurinë, përfshirë edhe luftën kibernetike.



FLET PËR "EPOKËN E RE" DEPUTETI I PDK-SË, HISEN BERISHA

Vuçiqi sërish ka plane për ta rrezikuar integritetin dhe sovranitetin e Kosovës në veri

Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Hisen Berisha, në një intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ka folur për Samitin e Procesit të Berlinit të mbajtur në Tiranë, për deklaratën e presidentit francez Emmanuel Macron rreth pezullimit të vizave për Kosovën nga Franca, për vizitën e Vuçiqit në Kinë dhe ndikimin e saj në rajon dhe për situatën e sigurisë pas 24 shtatorit në veri të Kosovës. Berisha ka thënë se deklarata e Macronit është shqetësuese për zotimet që ka marrë kryeministri Kurti në procesin e dialogut. Ndërkaq sa i përket situatës në veri, deputeti i PDK-së thotë se sërish ka rrezik që Serbia të përsërisë skenarë të tjerë në veri

EPOKA E RE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 TETOR -

"Epoka e re": Z. Berisha, Samiti i Tiranës për Procesin e Berlinit, në Piramidën e Xhaxhit, ishte ko incidencë apo orientim ideologjik?

Berisha: Së pari Samiti i Procesit të Berlinit që u mbajt në Tiranë është sukses i shtetit shqiptar, por edhe i kryeministrit Rama. Sa i përket mbajtjes së samitit në një objekt të ndërtuar në kohën e regjimit komunist, duhet marrë me sportivitet. Pra, siç deklaroi ish-presidenti Nishani në fjalën e tij në 100-vjetorin e pavarësisë së Shqipërisë, ndër shumë vlera kombëtare, "edhe diktatura

komuniste është pjesë e historisë sonë të errët", por edhe regjimet totalitare lënë ndonjë vepër arkitektonike apo diçka tjetër me vlerë. Kjo nuk duhet parë që ka të bëjë me orientim ideologjik.

Mendoj se kryeministri Rama ka dashur të tregojë se si një objekt komunist, gati të shëmtuar, e kthen në një objekt modern dhe atraktiv dhe me këtë dërgoi mesazh se Shqipëria tashmë e ka mbyllur tranzicionin dhe është gati për transformim në rrugën drejt BE-së. Mekanizmat shtetërore të Kosovës duhet t'i shmangin nismat integruese që nuk janë në frymën e integriteteve euroatlantike, me theks "Shengenin Ballkanik" apo "Ballkanin e Hapur", i cili u ideua si

revansh ndaj BE-së dhe orientim shantazhues drejt Unionit Euroaziatik që do ta çonte Kosovën në zhbërje si shtet e jo në integritete euroatlantike. Më në fund po i mbetet të kaluarës së shëmtuar politike ashtu si varri faraonik "piramida".

"Epoka e re": Si e patë deklarimin e presidentit francez Emmanuel Macron për pezullimin nga Franca të liberalizimit të vizave për Kosovën?

Berisha: Po lajmi preliminar nga ky samit është edhe një masë ndëshkuese e paralajmëruar nga presidenti francez Macron, e cili u interpretua si "përkthim i gabuar" që ka të bëjë me mospërfitim të liberalizimit të vizave për qytetarët

e Kosovës. E kjo në këtë frymë "përkthimi të gabuar" interpretohet si rezultat i moskonsistencës në marrëdhëniet kontraktuale ndërkombëtare obligative të palëve, në këtë rast i Kosovës. Me këtë paralajmërim të "përkthyer gabimisht" u tregua se ky samit në Tiranë nuk iu shërbeu shqiptarëve, ani se presidenti Macron deklaroi sipas "përkthimit të gabuar" se Franca e ka pushuar liberalizimin e vizave shkak i shtetarëve kosovarë, presidentes Osmani dhe kryeministrit Kurti, për shkak "të mosrespektimit të fjalës së dhënë" në dialog dhe detyrimet kontraktuale ndërkombëtare, siç u theksua konkretisht, asociacioni. Por, një asociacion në trajtën e autonomisë territoriale, politike për veriu, si vetëmenaxhim që ka propozuar qeveria Kurti, nuk duhet kaluar edhe me kushtin e pezullimit të liberalizimit të vizave. Kosova unike me integritet territorial e sovranitet politik të pacenuar, është mbi të gjitha interesat, duke përfshirë edhe liberalizimin e vizave. Por, në leximin tim kemi të bëjmë me një zhvillim tejet shqetësues në zotimet që ka marrë kryeministri Kurti në procesin e dialogut. Presidenti Macron zbuloi diçka të

tmerreshme për kryeministrin Kurti. Ai tha se "në e mbajtëm fjalën për liberalizim të vizave, prandaj Kurti duhet ta mbajë zotimin për marrëveshjet e bëra". Pra, Kurti me marrëveshjet e Brukselit alias planin franko-german dhe aneksin e Ohrit, e rrezikoi funksionalitetin dhe sovranitetin e vendit vetëm që ta ruajë rejtungun në elektoratin e vendit. Kjo është pikërisht ajo që kisha paralajmëruar, rrëshqitja drejt tradhtisë ndaj interesave të shtetit.

"Epoka e re": Çfarë mesazhi mund të përcjellë vizita e Vuçiqit në Kinë?

Berisha: Serbia po merr pjesë në samitin e Tiranës e përfaqësuar nga Bernabiç, ndërsa në Kinë takimi i Vuçiqit me Putinin tregon shumë qartë se BE-ja as që guxon ta ndëshkojë Serbinë pavarësisht se si ajo sillet. Po ashtu, ky është një mesazh në rend të parë për miqtë e partnerët perëndimorë, se nuk duhet të krijojnë iluzion se Serbia do të bëhet një vend demokratik e do t'i mbështesë vlerat perëndimore së shpejti. Mendoj se "trethimi" izolues e zvetënues i Serbisë është alternativa e vetme. Pra, të gjitha vendet përreth saj të bëhen pjesë e plotë e NATO-s dhe BE-së, përveç Serbisë. Orientimi i

Lideri i PDK-së me bashkëpartiakë dhe me djalin e Thaçit vizitojnë Gucatin



SKENDERAJ, 19 TETOR - Lideri i Partisë Demokratike Kosovës, Memli Krasniqi, së bashku me bashkëpartiakë dhe me djalin e Thaçit, Endritin, kanë vizituar Hysni Gucatin, i cili është liruar dy ditë më parë nga Gjykata Speciale. "Në konakun e luftëtarit të UÇK-së, Hysni Gucati, për t'ia uruar

lirimin nga Gjykata Speciale në Hagë. Krenar për të kaluarën e lavdishme dhe optimist për të ardhmen, Hysi sot reflektonte edhe forcën dhe qëndresën e çlirimtarëve të tjerë që po vazhdojnë të mbahen në Hagë. Me shpresën që drejtësia do të triumfojë edhe në betejën e fundit

të Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Jakup Krasniqit, Rexhep Selimit dhe bashkëluftëtarëve të tyre, për të vërtetën e luftës së drejtë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, uroj që edhe ata të kthehen sa më parë në mesin tonë", ka shkruar në "Facebook" lideri i PDK-së, Memli Krasniqi.

Forumi Shqiptar do të jetë pjesë e qeverisë së re në Mal të Zi

PRISHTINË, 19 TETOR - Bartësi i Listës së Forumit Shqiptar, njëherësh kryetar i komunës së Tuzit, Nik Gjelosaj, ka bërë me dije se në takimin që është mbajtur të mërkurën në mbrëmje, kanë vendosur që t'i mbështesin parimet programore të mandatarit Millojko Spajiq për formimin e Qeverisë së 44-t të Malit të Zi, dhe kanë pranuar pjesëmarrjen në të. "Si subjekti politik më i madh i shqiptarëve në Mal të Zi, Forumi Shqiptar në këtë mënyrë synon ta vërtetojë përkushtimin programor të të gjithë subjekteve që e përbëjnë, se shqiptarët në Mal të Zi të jenë partner i vërtetë i të gjithë forcave demokratike pro-perëndimore në Mal të Zi në rrugën e tij evropiane dhe euroatlantike. Marrja e vendimit të këtillë është lehtësuar me



frymën demokratike pro-perëndimore të vet parimeve programore të mandatarit Spajiq, veçanërisht atyre që flasin për vendosmërinë për të qëndruar në rrugën drejt hyrjes në BE, me gatishmëri për harmonizimin e plotë të politikës së jashtme të Malit të

Zi me politikën e jashtme dhe të sigurisë së BE-së, duke përfshirë edhe sanksionet ndaj Rusisë për shkak të agresionit ndaj Ukrainës, si dhe që Mali i Zi të jetë vend anëtar i besueshëm i Aleancës NATO dhe që ta vazhdojë bashkëpunimin miqësor me të gjitha vendet

fqinje, përfshirë edhe Republikën e Kosovës", ka thënë Gjelosaj. Ai ka thënë se këtë përkrahje e bëjnë edhe për shkak të qëllimit të tyre që me pjesëmarrje në qeveri t'i kontribuojnë avancimit të statusit dhe pozitës së shqiptarëve në Mal të Zi, në themele të standardeve demokratike të BE-së që i referohen çështjes së të drejtave të pakicave kombëtare. "Në këtë drejtim, Forumi Shqiptar do të ofrojë një dokument konkret, që mbi parime të aksionit afirmativ, do të mundësojë pjesëmarrjen e barabartë të shqiptarëve në procese shoqërore, me theks të veçantë te përfaqësimi proporcional i tyre në institucione të shtetit dhe shërbime publike të Malit të Zi, si dhe te decentralizimi i pushtetit, që nënkupton më

shumë autonomi për vetëqeverisjet lokale". "Për t'i arritur të gjitha të sipërpërmendurat, Forumi Shqiptar është i gatshëm për bashkëpunim edhe me subjektet me të cilët, në procese demokratike të deritanishme, ka pasur dallime, por të cilat dallime i ka zbutur koha dhe ka bërë që të kuptohet domosdoshmëria e veprimit të përbashkët drejt forcimit dhe kultivimit të mëtejshëm të bashkëjetesës në Malin e Zi demokratik, të pavarur dhe sovran. Kjo konfirmohet edhe me nënshkrime të të gjitha subjekteve që i japin mbështetje qeverisë së ardhshme për marrëveshjen e propozuar, përkushtimet programore të cilës janë kompatible edhe me qëllimet programore të Forumit Shqiptar", ka theksuar Gjelosaj.

Nuk ka më listë të pritjes për terapinë me rrezatim në Klinikën e Onkologjisë

PRISHTINË, 19 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, gjatë vizitës që ka bërë në Klinikën e Onkologjisë, është njoftuar nga menaxhmenti i Klinikës se falë sigurimit të aparatit të ri për rrezatim është arritur të eliminohet lista e pritjes. "Është kënaqësi të dëgjoj se më nuk ka listë pritje për radioterapi, në Klinikën e Onkologjisë, falë investimeve që kemi bërë dhe punës shembullore të stafit të Klinikës së Onkologjisë që po punojnë

me përkushtim dhe profesionalizëm", u shpreh ministri Vitia. Ai theksoi se janë ndarë afër 1 milion euro për investime të reja në këtë klinikë, që parashihet zgjerimi i shtretërve, shërbimeve, por edhe rinovime të hapësirave. Drejtori i Klinikës së Onkologjisë, dr. Ilir Kurtishi, ka falënderuar ministrin Vitia për përkrahje, e që ka mundësuar të hiqet lista e pritjes. "Më nuk kemi pritje për radioterapi, përjashtuar

rastet kur për arsye mjekësore pacientëve u caktohet data se kur duhet të fillojnë me rrezatime, raste të tjera nuk presin", ka thënë ai. Kurtishi pohoi se me renovimin dhe zgjerimin e hapësirave puna do t'i lehtësohet edhe stafit shëndetësor, ndërsa shtimi i kapaciteteve të shtretërve dhe riorganizimi i dhënies së shërbimeve onkologjike do t'i plotësojë nevojat dhe cilësinë organizative të shërbimit në Klinikën Onkologjike.



KMDLNj kërkon nga Prokuroria e Shtetit që urgjentisht t'i hetojë pohimet publike të Osmanit se është kërcënuar

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 19 TETOR - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave e të Lirive të Njeriut (KMDLNj) përmes një reagimi ka theksuar se të mërkurën presidentja Vjosa Osmani në një konferencë për medie shpërndau njoftimin për publikun (më vonë ua dërgoi edhe medieve) të përmbledhur në 18 faqe për arsyet pse nuk e dekretoi Blerim Isufajin për Kryeprokuror të Shtetit. Sipas KMDLNj-së, në praktikat juridike komunikimi përmes shpërndarjes së informatave nuk prodhon efekt juridik sikur që ishte rasti me Blerim Isufajin. "Se a ka qenë i mbështetur në fakte refuzimi i dekretimit është çështje e ekspertëve të fushës dhe deputetëve që, si përgjigje këtë rast mund ta dërgojnë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës, jo pse e ka refuzuar dekretimin por se me mosveprim apo shkelje të diskrecionit ka dëmtuar edhe Blerim Isufajin sikur edhe kundërkandidatin e tij, Shqipdon Fazliun. Të parin e ka eliminuar duke mos e dekretuar dhe duke mos i dhënë mundësi ankimit



që, përveç se është e drejtë ligjore, është edhe e drejtë elementare e njeriut që ia garanton Kushtetuta e Kosovës. Ndërsa, të dytin duke e endur zyrave të gjykatave ia ka humbur mundësinë duke e shpallur rastin si të pasafatshëm. Në rrethana normale, nëse Isufaj do të pamundësohej, z. Fazliu sigurisht se do të zgjidhej, gjithnjë nëse i referohemi rasteve të ngjashme para Gjykatës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut në Strasburg", është theksuar në reagimin e KMDLNj-së.

KMDLNj ka theksuar se presidentja e Kosovës në konferencën për medie, pastaj

edhe në një medium elektronik, deklaroi se për rastin e mosdekretimit të Blerim Isufajit ka pasur kërcënime nga rrethi brenda KPK-së për të cilat e paska informuar një sinjalizues, identitetin e të cilit nuk e bëri publik. "Kërcënimet shkonin nga ajo se: 'mund t'i krijojnë dosje, t'i ngrënë aktakuzë e deri te ajo se mund t'ia lidhin duart (ta arrestojnë)...' e që për KMDLNj-në, nëse kjo vërtetohet paraqet vepër të rëndë penale të rrezikimit të jetës së presidentes si dhe sigurisë së Kosovës, si pasojë e mundshme dhe e skajshme. Pastaj, po në të njëjtën konferencë, presidentja e Kosovës

pasi e denoncoi kërcënimet që i kishin bërë, deri më tani të pavërtetuara, po të njëjtën armë - kërcënimin, në formë më të butë e përdori kundër opozitës që eventualisht do ta dërgonin rastin në Gjykatën Kushtetuese duke thënë se: 'me ata që do ta dërgonin rastin në Gjykatën Kushtetuese do të bëjë luftë politike pasi ajo ligjorja paska marrë fund...'. Me mosparaqitjen e rastit të kërcënimit para institucioneve përgjegjëse, presidentja e Kosovës e ka fshëhur rastin që është i dënueshëm me ligjet e aplikueshme në Kosovë. Në anën tjetër sinjalizuesi hipotetik, nëse është rasti i vërtetë ka mundur dhe ka pasur detyrim që këto kërcënime t'i paraqes në Policinë dhe Prokurorinë e Shtetit e jo në Zyrën e presidentes së Kosovës. Pasi pohimi i presidentes së Kosovës për kërcënim ndaj saj ishte publik dhe i përsëritur, Policia e Kosovës, me urdhër të prokurorit, sipas detyrës zyrtare është dhe duhet të trokasë në Zyrën e presidentes në mënyrë që të marrë masa parandaluese dhe ligjore ndaj kërcënuesve të mundshëm sikur edhe ta

thërrasin sinjalizuesin hipotetik të tregojë identitetin e kërcënuesve, pa e ekspozuar në publik", theksohet në reagimin e KMDLNj.

KMDLNj kërkon nga Prokuroria e Shtetit që urgjentisht t'i hetojë pohimet publike të presidentes Osmani se është kërcënuar dhe, nëse sigurohen prova, të ndërmarrë veprime dhe masa ligjore ndaj kërcënuesve, në të kundërtën duhet të informohet opinioni se këto kërcënime janë vetëm për përdorim politik. "Të gjithë, pavarësisht posteve që i kanë apo statusit në shoqëri e kanë detyrim ta thonë të vërtetën që duhet ta mbështesin me fakte sidomos në rastin e presidentes Osmani, që nëse dëshmohet se është i vërtetë ka peshë të veçantë sepse ndërlidhet me sigurinë e shtetit. Deputetët e Kuvendit të Kosovës, pa dallim se a janë pozitë apo opozitë, bindjeve dhe përcaktimeve politike a partiake duhet të reagojnë përmes një seance të jashtëzakonshme dhe rasti të mos kalojë në heshtje, i pahetuar apo i pandëshkuar për kërcënuesit e mundshëm apo për sajuesit e mundshëm!", ka theksuar KMDLNj.



Sejdiu nënshkruhet në Librin e Zisë me rastin e vdekjes së ish-presidentit Ahtisaari

PRISHTINË, 19 TETOR - Presidenti i Republikës së Kosovës në vitet 2006-2010, Fatmir Sejdiu, të enjten u nënshkrua në Librin e Zisë në Ambasadën e Finlandës në Prishtinë, duke shprehur ngushëllime dhe kujtuar me pietet, personalitetin dhe kontributin e ish-presidentit Marti Ahtisaari dhënë për pavarësinë e Kosovës. Po kështu, presidenti Sejdiu i dërgoi telegram ngushëllimi familjes së ish-presidentit Ahtisaari.

Në telegram ai shkruan: "E nderuar familje Ahtisaari, mora me pikëllim të thellë lajmin për ndarjen nga jeta të presidentit Marti Ahtisaari, burrështetasit shembullor finlandez si dhe diplomatit nga më

të shquarit e kohës sonë, krijuesin e paepur të paqes dhe mirëkuptimit ndërmjet popujve. Presidenti Ahtisaari do të kujtohet përherë nga qytetarët e Kosovës si personalitet që nuk kurseu gjithë energjinë e tij për pavarësimin dhe shtetbërjen e Kosovës si zgjidhje dhe vullnet i qytetarëve të saj. Unë dhe qytetarët e Kosovës gjithmonë do ta vlerësojmë si thesar të çmuar kontributin e Tij si dhe rolin që luajti për mirëqenien e vendit tonë. Isha me fat që kisha mundësinë të punoj me të dhe kujtimi i tij do të mbetet gjithmonë i dashur. Ju lutem, në këto çaste të pikëllimit Tuaj, pranoni ngushëllimet e mia më të sinqerta për humbjen e njeriut tuaj të dashur".

Prokuroria Speciale shenjëstron një rast të ri, konfiskon armatim, 30 vetura dhe pasuri të paluajtshme

PRISHTINË, 19 TETOR - Kryeprokurori i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), Blerim Isufaj, ka mbajtur të enjten takimim e radhës me ekipin e përbashkët për përzgjedhjen dhe shenjëstrimin e krimeve të

rënda, ku ka shenjëstruar një rast të ri. Prokuroria Speciale njofton se rasti është shenjëstruar për "Shpëlarje të parave" si dhe për vepra të tjera penale. Gjithashtu, ka njoftuar se në kuadër të hetimeve janë sekuestruar

dhe konfiskuar sasi e madhe e armatimit të llojit të ndryshëm, rreth 30 vetura, si dhe pasuri të paluajtshme rreth 20 000 000 euro. Në këtë rast janë të ndaluar tre persona dhe, sipas vendimit të gjykatës, janë nën masën e paraburgimit.



Banka Botërore: Rritja ekonomike në Kosovë pritet të përshpejtohet në vitin 2024



PRISHTINË, 19 TETOR - Pas ngadalësimit në vitin 2023, rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor pritet të kalojë në përshpejtim të moderuar në vitin 2024, duke arritur në tre për qind përballë rimëkëmbjes së vazhdueshme në Bashkimin Evropian, partneri kryesor tregtar i rajonit, ndërkohë që inflacioni më i ulët duhet të ndihmojë në forcimin e të hyrave të disponueshme dhe mbështetjen e konsumit, thotë Raporti i ri Ekonomik i Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor, i publikuar të enjten.

Shkalla e rritjes rajonale në vitin 2024, edhe pse më e shpejtë se në vitin 2023, mund të jetë 0.1 për qind më e ulët seç ishte parashikuar nga Banka Botërore në edicionin e mëparshëm të raportit në muajin prill. Projektioni i rritjes për vitin 2025 është mbajtur i pandryshuar në 3.5 për qind.

Rimëkëmbja dhe kthimi në nivelet para pandemisë vijnë me dallime ndërmjet vendeve. Rritja në Mal të Zi dhe Shqipëri ishte më e fortë seç

pritej në vitin 2023, e nxitur nga një sezon i fortë turistik, ndër faktorët e tjerë, dhe mund të ngadalësohet pak në vitin 2024.

Rritja në Serbi, Maqedoni të Veriut, Bosnjë-Hercegovinë dhe Kosovë parashikohet të përshpejtohet në vitin 2024, e mbështetur nga rritja e konsumit dhe e investimeve. "Përkundër goditjeve të shumta që përjetuan ekonomitë evropiane, Ballkani Perëndimor ishte në gjendje të rritej, të krijojë vende të reja pune dhe ta reduktojë varfërinë në nivelet më të ulëta të regjistruara, duke dëshmuar themelet e forta ekonomike të rajonit", ka thënë Xiaoqing Yu, drejtoreshë e Bankës Botërore për Ballkanin Perëndimor. "Është inkurajuese që Ballkani Perëndimor vazhdon të përparojë drejt uljes së hendekut me ekonomitë e përparuara të Bashkimit Evropian. Megjithatë, konvergjenca po ecën me shpejtësi të ndryshme në ekonomi të ndryshme, çka kërkon reforma efektive për ta konsoliduar rimëkëmbjen drejt rritjes së qëndrueshme", ka thënë ajo.

Në Kosovë, si kudo në Ballkanin Perëndimor, përballë kushteve të jashtme sfiduese, rritja reale e BPV-së u ngadalësua, por mbetet pozitive.

Aktiviteti ekonomik pritet të zgjerohet 3.2 për qind gjatë vitit 2023.

Inflacioni ka qenë në rënie të vazhdueshme nga kulmi i tij prej 14.2-përqindësh në korrik 2022, por presionet mbi çmime mbeten të larta.

Perspektiva afatmesme mbetet pozitive, në kontekstin e një pasigurie të lartë. Kontributi i investimeve në rritjen ekonomike pritet të jetë më i lartë në periudhën 2024-2025, i mbështetur nga rritja e investimeve në infrastrukturë publike, përfshirë këtu edhe projektet me financim të jashtëm, si dhe investimet më të larta publike dhe private në kapacitete prodhuese dhe në eficientë të energjisë. "Për Kosovën është i domosdoshëm zbatimi në kohë dhe efektiv i Strategjisë së re të Energjisë duke ruajtur stabilitetin fiskal krahas nevojës për ta

reduktuar hendekun që Kosova ka në infrastrukturën e sektorit të ujërave, mbeturinave dhe ndërlidhjes [transportit ndërkombëtar]", ka deklaruar Massimiliano Paolucci, menaxher i Bankës Botërore për Kosovën dhe Maqedoninë e Veriut.

Ai ka shtuar se rritja e shkallës së investimeve në kapital njerëzor dhe përfshirja më e madhe e grave joaktive në tregun e punës, duke reduktuar barrierat për pjesëmarrje, gjithashtu duke rritur qasjen në shërbimet e kujdesit për fëmijë, janë një parakusht për ta çliruar potencialin për rritje më të lartë ekonomike.

Në vitin 2023 tregu i punës në Ballkanin Perëndimor vazhdoi të forcohej përkundër të gjitha gjasave. Shkalla mesatare e punësimit në rajon arriti nivelin e ri historik në pothuajse 48 për qind, me 103 000 vende të tjera pune të krijuara nga mesi i 2022-s deri në mes të vitit 2023. Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina dhe Mali i Zi patën përfitimet më të larta. Në të njëjtën kohë, mungesa e fuqisë punëtore vazhdon të jetë ndër

shqetësimet kryesore të ngritura nga bizneset në Ballkanin Perëndimor. Përkundër momentumit në vitet pas pandemisë, pjesëmarrja në fuqinë punëtore mbetet e ulët dhe, së bashku me hendekët e konsiderueshëm gjinorë, po kufizon uljen e mëtejshme të varfërisë.

Sipas raportit, rajoni duhet jo vetëm t'i adresojë barrierat ndaj pjesëmarrjes më të madhe në fuqinë punëtore, por ta përshpejtojë konvergencën ekonomike me ekonomitë më të përparuara të Evropës. Këto përpjekje duhet të plotësohen me hapa të përshpejtuar në tranzicionin e gjelbër dhe me më shumë investime për ta rritur reziliencën ndaj fatkeqësive natyrore, duke përfshirë bujqësinë. "Bujqësia është një nga sektorët më të prekur nga thatësitë, shkurtimi i stinëve dhe modelet e paparashikueshme të motit. Mbrojtja e bujqësisë nga rreziqet natyrore dhe bërja e saj më e qëndrueshme do t'u mundësojë ekonomive të Ballkanit Perëndimor ta vazhdojnë rritjen e produktivitetit bujqësor përkundër problemeve nga ndryshimi i klimës dhe të jenë në gjendje të prodhojnë në mënyrë të qëndrueshme më shumë ushqime me cilësi të lartë për qëllime të brendshme, por edhe për eksporte, përfshirë në BE", ka thënë Natasha Rovo, ekonomiste e lartë e Bankës Botërore dhe autore udhëheqëse e raportit. Sipas saj, kjo kërkon përmirësimin e politikave publike dhe investimeve për rritje të përvetësimin të gjerë nga fermerët e teknologjive dhe praktikave të mençura për klimën, mbështetur nga institucione publike më të forta, kritike për rritjen e qëndrueshme bujqësore.

Ndërkohë që po zvogëlohen përmasat e sektorit të bujqësisë në rajon, ai mbetet shumë i rëndësishëm, për shembull, duke punësuar nga 7 deri në 35 për qind të popullsisë në të gjashtë vendet. Gjelbërimi i bujqësisë ofron një mundësi për ta rritur produktivitetin, konkurrueshmërinë dhe reziliencën e sektorit, duke i përdorur efektisht fondet publike të disponueshme, njohuritë dhe inovacionin.

AKP-ja shiti 37 asete në vlerë mbi 1.5 milion euro

PRISHTINË, 19 TETOR - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), në ceremoninë e hapjes së ofertave të shitjeve nr. 63 përmes metodës së likuidimit, shpalli fituesit e përkohshëm për 37 asete të ndërmarrjeve shoqërore në likuidim që ishin në dispozicion për shitje.

AKP-ja njoftoi se vlera e tërësishme e këtyre aseteve ishte mbi 1.5 milion euro. Në komunikatën për medie thuhet se dorëzimi i ofertave

nga investitorët, hapja e ofertave dhe publikimi i rezultateve janë bërë në mënyrë transparente para përfaqësuesve të medieve, përfaqësuesve të Odës Ekonomike të Kosovës dhe Odës së Avokatëve të Kosovës si dhe investitorëve të pranishëm. "Për 37 asete sa ishin në shitje u pranuan gjithsej 80 oferta dhe vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte 1,515,219 euro",

thuhet në komunikatë. Muharrem Arifi, u.d. zëvendës drejtor ekzekutiv, operativë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, i informoi të pranishmit se deri më tani janë privatizuar 2,913 asete të ndryshme përmes shitjeve të aseteve të ndërmarrjeve shoqërore në administrim të Agjencisë. Ai tha se në Fondet e Mirëbesimit deri më tani janë grumbulluar gjithsej 783,632.386 euro.



Kryeministri i Qeverisë së parë të Palestinës ka qenë shqiptar

Nga: Daut DAUTI

Këto dokumente janë nga Arkivi Kombëtar Britanik, që janë korrespondencë diplomatike e Foreign Office-it [Ministrisë së Jashtme], dhe flasin për qeverinë e parë të Palestinës të formuar në vitin 1948. Kryeministër, siç shihet edhe në këto dokumente, ka qenë Ahmet Hilmi Pasha (1884-1963), një shqiptar i lindur në Sidon apo Saida të Libanit. Pasi që ishte shqiptar, arabët e quanin Ahmed Al Arnauti.

Hilmi Pasha ka qenë një lloj gjeniu në financa, por edhe në politikë dhe ushtri. Në Perandorinë Otomane ka shërbyer disa herë si ministër i Financave, ndërsa si ushtarak kishte gradën e gjeneralit. Pas rënies së Perandorisë Otomane, shërbeu si ministër dhe këshilltar i financave në disa vende arabe dhe është themelues i bankave të para arabe.

Pasi që gëzonte popullaritet të madh dhe pasi që kishte ndihmën e dinastisë shqiptare të



1948	E	52
10393	PALESTINE	E 10393
Registry Number: 210393/375/31	Arab League Administration in Palestine: non-arrival of the members of the projected administration	
TELEGRAM FROM Consul-General, JERUSALEM. No. 340 Confidential 3.8.48 Received in Registry 5.8.48	Refers Foreign Office telegram no. 1267 to Cairo, of 22nd July (29552/375/31). Some of the members of the projected administration has arrived in Palestine, with the exception of Ahmed Hilmi Pasha. Reported to United Kingdom Delegation, New York, Washington, and Jeddah.	
Last Paper: E 1022	(Notes)	
References:	This confirms the impression we have gained from telegrams from other parts that the Arab Civil Administration in occupied Palestine has little existence except on paper.	
(Print)	M.F. 5/ 20/ 18 M.F. I.D. 2/ 18 Research Dept. 6/20/18	
(How disposed of)	3/ Palestine Dept August	
(Action completed)	(Index)	
Next Paper: 210460	END PAP.	

1. AHMAD HILMI PASHA was born in 1884. He is of Albanian origin and served as a Turkish finance official until 1918. He was Finance Minister to King Feisal during the latter's short period of rule in Syria, from whence he was exiled by the French owing to his association with extreme Arab political movements. He served in Amman from 1922-24 as Finance Minister. He had to leave both Transjordan and Palestine owing to his political activities as a member of the Istiqlal party. Later he was permitted to re-enter Palestine as result of the intercession of the Mufti. He and his son-in-law Abdul Hamid Shuman founded the Arab Bank, but, later on falling out with his partner, he established in 1933 the Arab National Bank, of which he is the present chairman. He also was responsible in 1935 for the renaissance of the "People's Fund", which had as its aim the buying up of Arab land which might otherwise have fallen into Jewish hands. His efforts met with only moderate success. Various plans to amalgamate the fund with the Beit al-Mal, the fund administered by the Mufti, have never materialised. Having achieved a prominent position among the Palestinian Arabs through his financial influence, he was appointed a member of the first Arab Higher Committee. He was deported with other members of the Committee to the Seychelles, from whence he was permitted to return to Palestine in 1940. He was elected to the second Arab Higher Committee formed in November, 1945. Recognising the potential strength of the Jews, he aimed at procuring unity among the Palestine Arabs, and favoured the launching of a revolution before the termination of the Mandatory Government. Never a friend of the Husseini faction, he has latterly shown himself as opposed to the Mufti. After the termination of the Mandate he was the only member of the Arab Higher Committee left in Jerusalem, of which he has apparently become the Arab Military Governor.

Egjiptit, Hilmi Pasha u zgjodh kryeministër i qeverisë palestineze. Kjo qeveri kishte tetë ministra arabë të Palestinës,

dy nga të cilët ishin të krishterë. Qeveria e Hilmi Pashës ka funksionuar disa vite, por ra nën hije dhe u bë e parëndësishme,

pasi që Amerika dhe disa vende evropiane kishin plane të tjera, të cilat po shihen edhe sot. /Telegrafi/

John F. Kennedy: 5 teoritë e vrasjes së Presidentit

1. Mërgimtarët kubanë

Në vitin 1961, administrata Kennedy miratoi pushtimin e Gjirit të Derrave – një përpjekje e fshehtë për të rrëzuar regjimin problematik të Fidel Kastros në Kubë. Të mbështetur nga CIA, një brigadë mërgimtarësh kreu sulmin. Por ishte dështim. Një pjesë e madhe e tyre u burgosën ose u vranë.

Kennedy u fajësua personalisht, sepse kishte refuzuar të ofronte mbështetje ajrore gjatë pushtimit. Sipas kësaj teorie, një kontigjent kubanezësh anti-Kastro, që kërkonin hakmarrje për fiaskon e Gjirit të Derrave, orkestruan vrasjen e Kennedy, ndoshta në bashkëpunim me agentë të pakënaqur të CIA-s.

2. CIA

Kjo teori mbështetet tek tensioni që u krijua midis presidentit dhe agjencisë së inteligjencës pas katastrofës së Gjirit të Derrave. Kennedy dyshohet se u zemërua e madje u zotua "të bënte CIA-n



pluhur e hi". Ai shkarkoi gjithashtu shefin e CIA-s, Allen Dulles, që kishte shërbyer për një kohë të gjatë, duke bërë që disa të dyshonin se Dulles ishte organizatori pas komplotit të

vrasjes. Një tjetër emër i CIA-s E. Howard Hunt, ka qenë prej kohësh i dyshuar se ishte një nga snajperët që qëlluan Kenedin. Familjarët e tij madje kanë pohuar se Hunt u rrëfye "në shtratin e vdekjes".

3. Mafia

Lee Harvey Oswald, u qëllua për vdekje, drejtpërdrejt në televizion, ditë pas atentatit. Vrasësi i tij ishte pronari i një klubi nate në Dallas, Jack Ruby. Shumë besojnë se Ruby ishte një vrasës mafioz, i cili kishte vrarë Oswald për të mos e lejuar të tregonte për përfshirjen e mafias në vrasje. Pse mafia e donte të vdekur? Disa thonë për shkak të dështimeve të tij për rrëzimin e Kastros. Të tjerë thonë se shkak ishin veprimet e Bob Kennedy, vëllai i presidentit, kryeprokuroor. Ky i fundit kishte nisur një fushatë kundër mafias. Sam Giancana, bosi i mafias së Çikagos, që kish dhënë një dorë për zgjedhjen e Kennedy në vitin 1960, ishte ndjerë i tradhëtar.

4. Presidenti Lyndon Johnson

Një nga të dyshuarit më të çuditshëm është Lyndon Johnson, zëvendëspresidenti i Kenedit, i cili u betua si Komandanti i Përgjithshëm atë ditë në Dallas.

Johnson ishte padyshim një nga politikanët më të pamëshirshëm të kohës së tij. Kjo, së bashku me thashethemet se Kennedy ishte gati ta hiqte Johnson-in nga kandidatura në zgjedhjet e 1964, ka bërë që disa teoricienë të besojnë se Teksani i etur për pushtet orkestroi vrasjen.

5. Clay Shaw dhe komplotistët e New Orleansit

Filmi JFK i Oliver Stone i vitit 1991 popullarizoi një teori konspiracioni: një grup aktivistësh të krahut të djathtë, anti-Kastro, të lidhur me CIA-n, të motivuar nga besimi i tyre se Kennedy ishte i butë ndaj komunizmit, komplotuan për të vrarë presidentin. Kreu i tyre ishte një biznesmen dhe autor shumë i dashur nga New Orleans, Clay Shaw. Në vitin 1969, Shaw u bë i vetmi person që i arrestuar dhe akuzuar ndonjëherë në lidhje me vrasjen e JFK. Por gjykatës iu desh më pak se një orë për ta shpallur Shaw të pafajshëm. /bota.al

Kush e goditi raketën mbi spital?



Një raketë goditi Spitalin Al-Ahli në qendër të Gazës, ku mijëra refugjatë kishin kërkuar mbrojtje ose po trajtoheshin. Sipas informacioneve palestineze, të paktën 500 persona kanë humbur jetën dhe shumë viktima janë ende nën rrënoja. Fotot tregojnë se janë gjetur trupa pa jetë. Dhjetëra të plagosur po trajtohen. Mjekët pa Kufij thanë se sulmi kishte shkaktuar një “masakër”. Sipas versionit të Izraelit, raketa thuhet se ka goditur kryesisht në parkingun e spitalit. Por kush e goditi raketën? Hamasi fajëson Izraelin për bombardimet, por ushtria izraelite e kundërshton fort dhe fajëson Xhihadin Islamik në Rripin e Gazës. Xhihadi Islamik është një organizatë terroriste islamike. Ideologjikisht nuk është i ndryshëm nga Hamasi, por mban gjithësesi kontakte shumë më të ngushta me Iranin.

Shpërthimi në parking

Zëdhënësi i ushtrisë izraelite Daniel Hagari njoftoi se do të bënte publike provat e akuzave. Sot në mëngjes fjalët e Hagarit u pasuan me veprime. Ushtria izraelite publikoi pamjet me dron në mediat sociale që ajo thotë se dëshmojnë se nuk shkaktuan një shpërthim vdekjeprurës në Spitalin Al-Ahli në Rripin e Gazës. Një video tregon parkingun e spitalit ku ndodhi shpërthimi. Pamjet tregojnë se shpërthimi ka shkaktuar një zjarr të madh, por nuk ka krater. Sipas ushtrisë, sulmet izraelite zakonisht lënë

gropa të mëdha në tokë. Pamjet me dron sugjerojnë gjithashtu se copëzat godasin çatitë e ndërtesave aty pranë.

Biseda e përgjuar

Nënkoloneli Jonathan Conricus, një tjetër zëdhënës i ushtrisë izraelite, i tha CNN se ushtria izraelite kishte përgjuar një bisedë të Xhihadit Islamik, në të cilën luftëtarët thuhet se kishin pranuar për një goditje me raketë që shkoj huq. Një regjistrim i bisedës do të publikohet, tha Conricus. Një mbështetës i Xhihadit Islamik thotë se ishte hera e parë që kishte parë një raketë të binte në atë mënyrë. Kjo është arsyeja pse ai supozon se raketa i përket Xhihadit Islamik. “Eshtë e jona?” pyet një nga palestinezët. “Kështu duket!” përgjigjet tjetri. Mbetjet e raketës tregojnë për një raketë tipike vendase. “Ata qëlluan nga varrezat pas spitalit dhe shkoi huq.” Regjistrimi nuk mund të verifikohet në mënyrë të pavarur. Prandaj, Izraeli flet për një lëshim të dështuar të raketës nga organizata militante palestineze. Videot tregojnë një raketë të lëshuar nga Rripin e Gazës duke shpërthyer në ajër dhe më pas mbetjet që bien në spital.

Si reagon Xhihadi Islamik

Xhihadi Islamik i cilësoi akuzat e bëra nga Izraeli si “gënjeshtër”. “Ne mendojmë se këto pretendime janë të rreme dhe të pabaza.” Izraeli dëshiron t’i “përdorë këto gënjeshtër për të justifikuar

sulmet e tij ndaj spitaleve” dhe “të shmangë përgjegjësinë për krimet e veta”, tha Xhihadi Islamik. Sipas lëvizjes, spitali u urdhërua të evakuohej nga Izraeli nën kërcënimin e bombardimeve dhe ishte një bombë e hedhur nga një avion i ushtrisë izraelite që shkaktoi tragjedinë.

Ali Jadallah, një fotograf luftime me eksperiencë, thotë për New York Times: “Vështirë se mund ta përshkruaj atë që pashë. Unë kam qenë dëshmitar i vrasjes së familjes sime, por nuk mund ta përpunoj atë që pashë sot”. Kryeministri izraelit Benjamin Netanyahu ka mohuar me vendosmëri përgjegjësinë për sulmin me raketë. “E gjithë bota duhet ta dijë: ishin terroristët barbarë në Gaza ata që sulmuan spitalin në Gaza”, tha Netanyahu të martën. Nuk ishte ushtria izraelite. “Ata që vranë brutalisht fëmijët tanë, po vrasin edhe fëmijët e tyre,” vazhdoi ai.

Jordania anulon takimin me Biden

Jordania ka anuluar një takim midis Mbretit Abdullah II dhe Presidentit të SHBA Joe Biden të planifikuar për të mërkurën. Takimi, në të cilin ishte planifikuar të merrte edhe kreu i shtetit të Egjiptit Abdel Fattah al-Sisi, do të zhvillohet vetëm nëse arrihet një marrëveshje për t’i dhënë fund luftës dhe për të ndaluar “këto masakra”, tha ministri i Jashtëm Ayman al-Safadi. Vetë Biden reagoi me shqetësim ndaj sulmit me raketa. Ai tha se

ishte “i indinjuar dhe thellësisht i pikëlluar” nga shpërthimi në spital dhe humbja e tmerrshme e jetëve që shkaktoi. Menjëherë pasi incidenti u bë i njohur, ai foli me Mbretin e Jordanisë Abdullah II dhe kryeministrin e Izraelit Benjamin Netanyahu dhe udhëzoi ekipin e tij të mblidhte informacione të mëtejshme për atë që ndodhi.

Presidenti palestinez Mahmud Abbas ka shpallur tre ditë zie kombëtare. Flamujt palestinezë do të jenë në gjysmështrizë.

Rusia kërkon prova nga Izraeli

Pas goditjes me raketë, Arabia Saudite dënoi ashpër “krimin e tmerrshëm”. Vendi fajësoi Izraelin për sulmin, sipas një deklaratë nga Ministria e Jashtme saudite të martën në mbrëmje. Riadi dënon “sulmet e vazhdueshme të pushtimit izraelit” ndaj civilëve. Presidenti francez Emmanuel Macron dënoi sulmin me raketa në Rripin e Gazës. “Asgjë nuk mund të justifikojë sulmin ndaj një spitali,” shkroi ai në X. “Asgjë nuk mund të justifikojë shënjestrimin e civilëve.” Duhet të sqarohen plotësisht rrethanat. Ministria e Jashtme ruse foli për një “krim të tmerrshëm” dhe kërkoi prova në formën e imazheve satelitore nga Izraeli. Të mërkurën foli edhe kancelari gjerman Olaf Scholz (65). “Jam i tmerruar nga pamjet që po marrim nga shpërthimi në një spital në Gaza. U plagosën dhe u vranë njerëz të pafajshëm.

Mendimet tona janë me familjet e viktimave. Është e rëndësishme që ky incident të sqarohet me shumë kujdes”, ka shkruar ai në X.

Protestat spontane

Protesta spontane shpërthyen në disa vende me shumicë myslimane. Milicia pro-iraniane Hezbollah, e cila është aktive në Liban, shpalli një “ditë zemërimi të paprecedentë” kundër Izraelit. Kjo është e drejtuar edhe kundër vizitës solidare të presidentit amerikan Joe Biden në Izrael të planifikuar për të mërkurën, njoftoi organizata shiite të martën vonë në mbrëmje. Biden dëshiron të “mbështesë regjimin kriminal”.

Hezbollah theksoi se fjalët e dënimit nuk mjaftonin më. Ai u bëri thirrje njerëzve në botën arabe dhe islame që të shprehin zemërimin e tyre përmes protestave.

Në Aman, demonstruesit u përpoqën të shkonin në ambasadën izraelite, siç raportoi agjencia jordaneze e lajmeve Petra të martën në mbrëmje. Qarqet jordaneze të sigurisë thuhet se hodhën poshtë raportet se ndërtesa ishte sulmuar. Demonstruesit u larguan nga zona.


Protestues të shumtë u mblodhën para konsullatës izraelite në metropolin turk të Stambollit mbrëmjen e së martës. Disa valëvitën flamuj palestinezë dhe brohoritën: “Poshtë Izraeli!”, sipas një transmetimi nga agjencia shtetërore e lajmeve Anadolu. Policia ndodhej aty me një kontigjent të madh për të mbrojtur konsullatën. Izraeli urdhëroi qytetarët e tij të largoheshin nga Turqia.

Reagon Irani

Sipas dëshmitarëve okularë, qindra mbështetës të Hezbollahut dolën në rrugë në periferitë jugore të Bejrutit dhe kërkuan që Tel Avivi të bombardohej.

Në Iran, një turmë në qendër të qytetit të Teheranit brohoriste “Poshtë Izraeli”. Qeveria e shpalli të mërkurën ditë zie. Zëdhënësi i Ministrisë së Jashtme të Iranit dënoi ashpër sulmin dhe fajësoi armikun e tij të madh, Izraelin. Në Teheran, qindra demonstrues u mblodhën para ambasadave britanike dhe franceze herët në mëngjes dhe bënë thirrje për “vdekjen e Anglisë dhe Francës”, raportoi një korrespondent i AFP. Disa mijëra njerëz u mblodhën gjithashtu në një shesh qendror në kryeqytetin iranian për të shprehur zemërimin e tyre për sulmin vdekjeprurës, raportoi një fotograf i AFP.

Të martën, Emiratet e Bashkuara Arabe dhe Rusia kërkuan një takim urgjent të organit më të fuqishëm të OKB-së, siç mësoi Agjencia Gjermane e Shtypit nga qarqet diplomatike. / *Blick – Bota.al*



SAINT-GOBAIN
SEKURIT
PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

Superliga e futbollit rikthehet me orar të ri

Prishtinë, 19 tetor - Superliga e Kosovës në futboll do të rikthehet këtë fundjavë pas pushimit prej dy javësh shkaku i angazhimeve të Kombëtares së Kosovës. Njëherësh do të nisë edhe

faza e dytë e sezonit 2023/24, respektivisht do të luhet xhironja e 10 e ligës elitare.

Një risi e kësaj fundjave është se ndeshjet do të nisin prej orës 13:00, pra dy orë më herët në krahasim me

xhirot paraprake. Padyshim, dueli kryesor do të jetë ai në mes të Llapit dhe Dritës, dy skuadra që i zënë dy prej tri pozitave të para në tabelë.

Kampioni aktual dhe lideri Ballkani do ta presë fqinjën,

Lirinë, kurse Prishtina do ta kërkojë fitoren pas një kohe të gjatë në duelin që do ta ketë në udhëtim me Feronikelimn 74.

Një ndeshje do të luhet sot (e premte), dy të shtunën dhe dy të dielën.



Asani: Më kërkojnë nga gjysma e Evropës, dëshiroj të transferohem në Serinë A

TIRANË, 19 TETOR - Tre gola vendimtarë dhe dy asistime në gjashtë ndeshjet kualifikuese të Shqipërisë. Dy herë fitues i çmimit goli më i bukur nga UEFA. Rrjeta me peshë, që kanë nënshtuar kundërshtarë me emër si Polonia dhe Çekia.

Jasir Asani është ylli i momentit të Shqipërisë, që ëndërron të luajë në Serinë A italiane. Një dëshirë

që mund të realizohet në merkaton e janarit. "Më kërkojnë në Itali, Gjermani, Arabi dhe Spanjë. Në janar do të transferohem te një nga këto liga. Si çdo shqiptar, jam i fiksuar pas Serisë A. Në Shqipëri, përveç klubit tonë të zemrës, të gjithë mbështesin një skuadër italiane", ka thënë Asani.

Ai ka folur edhe për mbështetjen

e tifozëve fantastikë të kombëtares. "Jam i bindur se nëse në Tiranë do të kishim një stadium si 'Camp Nou', shqiptarët do ta mbushnin plot. Jemi të çmendur për futboll". Aktualisht, 28-vjeçari luan te Guan-gju, por me ofertat nga ligat më prestigjioze, aventura në Korenë e Jugut pritët të përfundojë pas pak javëve.



Khaka në top 5 "mbretërit" e pasimeve në Evropë

BAYERN, 19 TETOR - Granit Khaka është një prej mesfushorëve më të mirë në Evropë në bazë të studimeve të fundit. Vetëm katër lojtarë kanë statistika të pasimeve më të mira sesa ylli kosovar në futbollin evropian. Përfaqësuesi zviceran ka lëvizur drejt Bayer Leverkusenit gjatë verës pas një përvoje që kishte në Arsenal.

31-vjeçari e ka nisur me plot sukses përvojën e re në Bundesligë, më saktësisht atë të dytë pasi në të kaluarën kishte luajtur në futbollin gjerman për Borussia Monchengladbachun.

Me Leverkusenin, Khaka është i pamposhtur në Bundesligë, ndërsa është bërë lojtar kyç i trajnerit Xabi Alonso. Khaka ka statistika impresionuese të pasimeve, të cilat ia kanë mundësuar atij të futet në mesin e pesë lojtarëve më të



mirë në Evropë në këtë aspekt. Kjo shihet në edicionin e fundit të Qendrës Ndërkombëtare të Studimeve Sportive (CIES) në Neuchatel. Në indeks përfshihet numri dhe përqindja e pasimeve të suksesshme për (lojë) krahasuar me lojtarë të tjerë.

Khaka i ka marrë 122.6 pikë duke përfunduar në vendin e pestë nga top 100.

Statistikat e tij impresionuese janë: 92.7 për qind e saktësisë së pasimeve me një mesatare prej 93 pasimesh për lojë. Përpara tij është bashkëlojtari Exequiel Palacios me vlerën 123.1. Vendi i parë i takon Rodrit të Manchester Cityt me 192.6 pikë, i ndjekur nga mesfushori i Barcelonës, Frenkie de Jong, me 165.3 pikë, ndërsa podiumin e kompletton mesfushori i Real Madridit, Toni Kroos, me 124.5 pikë.

Neymari pas lëndimit të tmerrshëm: Është çasti më i keq i jetës time

Brazilia, 19 tetor - Neymari ka folur për herë të parë pas lëndimit të rëndë që e pësoi në ndeshje me Perunë. Ylli brazilian ka këputur ligamentet e gjurit dhe do t'i duhet t'i nënshtrohet

operimit. Sipas medieve të huaja, ish-futbollisti i Barcelonës dhe Paris Saint-Germainit mund të mungojë deri në nëntë muaj. Gjendja e tij psikologjike është mjaft e

vështirë. "Është një çast mjaft i vështirë, më i keqi i jetës sime. E di se jam i fortë, por në këtë kohë kam nevojë për mbështetje të familjes dhe të miqve të mi. Nuk është e lehtë të

lëndohesh, të operohesh dhe më pas ta bësh atë përsëri pas vetëm katër muajsh. Unë kam besim. Këtë do ta lë në duar të Zotit", ka thënë përfaqësuesi brazilian.





REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOSKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUT

Prishtinë, 19.10.2023

Në bazë të Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 11/02 maj 2013), neni 31, Statutit të Institutit Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, neni 32, Ligjit të Punës nr. 03/L212, rishpallë:

KONKURS

- 1 (Një) bashkëpunëtor shkencor për edukim parashkollor-parafillor

Përshkrimi i punëve:

- Përgatit projekte kërkimore – shkencore nga fusha përkatëse;
- Studion probleme të ndryshme nga fusha e edukimit në kuadër të fushë veprimtarisë së sektorit;
- Bën analiza, vlerësime dhe hulumtime në fushën e edukimit;
- Punon në mënyrë të pavarur në hulumtimet shkencore të aprovuara nga organi përkatës, sipas planit të miratuar;
- Përgatit për botim raporte të studimeve të kryera, materiale e botime nga fushë veprimtaria e sektorit të hulumtimeve përkatëse;
- Kryen punë në kuadër të projekteve të përbashkëta hulumtuese – shkencore;
- Angazhohet në ngritjen e kapaciteteve kërkimore - shkencore në sektorin përkatës;
- U ndihmon hulumtuesve në kryerjen e detyrave të tyre;
- Harton planin e punës për aktivitetet vjetore;
- Përgatit raportin për punët e realizuara;
- Kryen punë të tjera që i delegon shefi i sektorit dhe drejtori.

Kandidati për bashkëpunëtor shkencor duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të ketë shkallën e doktorit të shkencave;
- Të ketë të botuar së paku një (1) punim shkencor në ndonjë revistë relevante ndërkombëtare në kuadër të lëmisë. Punimet duhet të jenë të njohura sipas rregulloreve në fuqi;
- Të ketë marrë pjesë në aktivitete shkencore brenda dhe jashtë vendit;
- Të ketë të botuar monografi shkencore nga fusha përkatëse.

Dokumentacioni i nevojshëm

Kandidati/ja duhet të dorëzojë dokumentacionin si vijon:

- Diplomën për përfundimin e studimeve përkatëse (doktoratës);
- Certifikatën e lindjes jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dokument të lëshuar nga organi kompetent me të cilin dëshmohet që nuk janë nën hetime;
- CV-në, së cilës duhet t'i bashkëngjiten dëshmitë e nevojshme për të vërtetuar gjendjen e paraqitur në të;
- Dëshmi për të arriturat shkencore (artikuj, libra, etj.)

Zgjedhja e personelit të Institutit Pedagogjik bëhet në pajtim me dispozitat e Ligjit nr. 04/L-135 për Veprimtari Kërkimore-Shkencore, dhe Statutit të Institutit Pedagogjik.

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilin konkurrojnë.

Kandidatët e përzgjedhur në listën e ngushtë do të informohen me shkrim ose me telefon në afat ligjor nga Instituti, dhe janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale mbi kualifikimet dhe trajnimet e kryera për verifikim para Komisionit.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në këtë nr. tel: 038/20020169, prej orës 08:00 - 16:00.

Aplikacionet e kompletuara dorëzohen në adresën: Instituti Pedagogjik të Kosovës në Prishtinë, (Pejton, rruga "Lorenç Antoni", nr.38).



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO
QEVERIA E KOSOVËS - VLADA KOSOVA
GOVERNMENT OF KOSOVA



INSTITUTI PEDAGOGJIK I KOSOVËS
PEDAGOŠKI INSTITUT KOSOVA
KOSOVO PEDAGOGICAL INSTITUT VLADA

Priština, 18.10.2023.

Na osnovu Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj delatnosti (Službeni list Republike Kosova, br. 11/02 maj 2013), član 31, Statuta Pedagoškog Instituta Kosova u Prištini, član 32, Zakona o radu br. 03/L212, ponovo objaviti :

KONKURS

- 1 (Jedan) naučni saradnik za predškolsko-predosnovno vaspitanje

Opis radova:

- Priprema istraživačko-naučne projekte iz odgovarajuće oblasti;
- Studira različite probleme iz oblasti vaspitanja u okviru delokruga sektora;
- Sprovodi analize, procene i istraživanja u oblasti obrazovanja;
- Radi na samostalan način u naučnim istraživanjima odobrenim od odgovarajućeg organa, prema usvojenim planom;
- Priprema za objavljivanje izveštaje izvršenih studija, materijala i objavljivanja iz delokruga sektora odgovarajućih istraživanja;
- Obavlja poslove u okviru zajedničkih istraživačko-naučnih projekata;
- Angažuje se u podizanju istraživačko - naučnih kapaciteta u odgovarajućem sektoru;
- Pomaže istraživačima u izvršavanju njihovih zadataka;
- Izrađuje plan rada za godišnje aktivnosti;
- Priprema izveštaj o realizovanim radovima;
- Obavlja druge poslove koje delegira šef sektora i direktor.

Kandidat za naučnog saradnika mora ispunjavati ove uslove:

- Da ima stepen doktora nauka;
- Da ima objavljen najmanje jedan (1) naučni rad u nekom relevantnom međunarodnom časopisu u okviru oblasti. Radovi moraju biti poznati prema propisima na snazi;
- Da je učestvovao u naučnim aktivnostima unutar i izvan zemlje;
- Da ima objavljenu naučnu monografiju iz odgovarajuće oblasti.

Potrebna dokumentacija

Kandidat/kinja mora dostaviti dokumentaciju kao što sledi:

- Diplomu o završenim odgovarajućim studijama (doktorate);
- Izvod iz matične knjige rođenih ne stariji od šest meseci;
- Dokument izdat od nadležnog organa kojim se dokazuje da nisu pod istragama;
- CV, kojim se moraju priložiti potrebni dokazi da se dokaže stanje prikazano u njemu;
- Dokazi o naučnim dostignućima (članci, knjige, itd.)

Izbor osoblja Pedagoškog instituta vrši se u skladu sa odredbama Zakona br. 04/L-135 o naučno istraživačkoj delatnosti, i Statuta Pedagoškog instituta.

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja.

Aplikaciji se prilažu kopije dokumentacije o kvalifikaciji, iskustvu i druga potrebna dokumentacija koja zahteva radno mesto za koje konkurisu.

Kandidati izabrani na užom spisku biće informisani pisano ili telefonom u zakonskom roku od Instituta, i dužni su da sa sobom donesu originalne dokumente o kvalifikacijama i obukama obavlenim za verifikaciju pred Komisijom.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na ovaj br. tel: 038/20020169, od 08:00 - 16:00 časova.

Kompletirane aplikacije se dostavljaju na adresu: Pedagoški Institut Kosova u Prištini, (Pejton, ulica "Lorenç Antoni", br. 38).



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada - Government

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Ministarstvo Životne Sredine Prostornog Planiranja i Infrastrukture
Ministry of Environment Spatial Planning and Infrastructure

Njoftim publik për konsultime në procedurën e fazës së I-rë
për Kushtet Ndërtimore

“Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Në bazë të Nenit 12 paragrafi 2 dhe 3 të Udhëzimit Administrative Nr.01/2019 për lëshimin e Kushteve Ndërtimore për projektet e kategorisë së III.

Në lidhje me kërkesën paraprake për kushtet ndërtimore për projektin “Ndërtimi i objektit për banim, Fshati turistik në Prevallë në kuadër të Parkut Kombëtar “Sharri”.

Nr. prot: 2316/23 të datës 03.05.2023, zyrtari përgjegjës i nënshkruar më poshtë informon publikun për hapjen e procedurës së konsultimeve për projektin e propozuar dhe fton publikun të dorëzojnë komentet dhe pyetjet e tyre, brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga data e këtij publikimi.

Komentet dhe pyetjet mund të dorëzohen në:

Posta rekomande:

Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës
Departamenti i Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Ndërtesa e Rilindjes
Kati i 14, zyra nr.1417, 10000 Prishtinë

Projekti mund të shkarkohet nga linku I mëposhtëm:

<http://mmph-rks.org/>

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni:

Departamentin e Planifikimit Hapësinor, Ndërtimit dhe Banimit
Telefon: + 381 38 200 32 222

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Stars Dental Care” SH.P.K. ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811922386 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Stars Dental Care” D.O.O. donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811922386 ujedno imenovao Likvidatora o sprovođenju postupka likvidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potraživanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform all customers that the limited liability “Stars Dental Care” L.L.C. has come to the decision to quit its business: 811922386 the company has appointed a liquidator who is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgage – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.



Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



www.facebook.com/gjejpuneshejte

RESTAURANT

SWISS

TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Bahtir Pllana B.I shpall te humbur Arkat Fiskale me nr: UNIK 8103571250, nr.arkes fiskale 1.GK05501061-0 2.GK05500991-0.

- Sevdije Sadiku shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Xheladin Deda”.

- Fatmir Shkodra shpall të pavlefshme diplomën e Fakultetit Ekonomik Prishtinë.

- Bislim Bislimi shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore “Fazli Greicevci”.

- Ruzhdi Rashiti shpall të pavlefshëm certifikatën e aftësimit profesional me numër protokolli: 5438/19 e lëshuar me 08.10.2019 në Ferizaj, drejtimi: Murator/Ndërtimtar.

- Eslem Gashi shpall te pavlefshme dëftesat, certifikatën , diplomën Q.K. “11 Marsi “ Prizren.

- Munir Anadoli shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Nuridin Isljami shpall te pavlefshme 4 dëftesat dhe diplomën Q.K.”11 Marsi “ Prizren.

- Taulant Gashi shpall te pavlefshme 4 dëftesat Q.K “11 Marsi “ Prizren.

- Nuhi Rexhepi shpall te pavlefshme diplomën Q.K. “11 Marsi “ Prizren.

- Hami Ramadan Bajraliu shpall të pavlefshme Diplomën e Universitetit të Prishtinës, drejtimi Ekonomik me nr. 742.

- Anita Uka shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës fillore nga kl. parë deri të nëntën të shkollës “Nazim Gafurri” Prishtinë.

- Naser Shunjaku nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike “Nexhmedin Nixha”.

- D.P.H. “Burimi” shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. 330286147-Gjilan.

- Bulent Bytyqi shpall te pavlefshme 4 dëftesat shme “ Ymer Prizreni “Prizren.

- Fikret Ajazaj shpall te pavlefshme diplomën shme “ Ymer Prizreni “ Prizren.

- Egzona Rustemi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. dhjetë (X), njëmbëdhjetë (XI) dymbëdhjetë (XII) si dhe Diplomën e Gjimnazit “Naim Frashëri” Shtime.

